

## PARIMET, MISIONI DHE VLERAT

### PARIMET

Lëvizja Feeding Albania beson se të gjithë në Shqipëri kanë të drejtën të marrin ushqime të sigurta dhe të shëndetshme që plotësojnë nevojat e dietës së tyre.

Feeding Albania dhe institucionet partnere:

1. Do të sigurojnë ushqim dhe ndihmë falas për ata në nevojë, pavarësisht racës, kombësisë apo origjinës etnike, qytetarisë, ngjyrës, besimit, burimeve të të ardhurave, moshës, aftësisë mendore apo fizike, apo çdo faktori tjetër diskriminues. *E drejta për ushqim është për të gjithë.*
2. Do të trajtojnë me dinjitetin dhe respektin më të madh të gjithë ata që kanë akses ndaj shërbimeve tona.
3. Do të implementojnë praktikatat më të mira në ruajtjen e duhur dhe të sigurtë të ushqimit
4. Do të respektojnë privatësinë dhe do të ruajnë privacinë e informacioneve personale të palës përfituese.
5. Nuk do të pranojnë asnjë lloj pagese për ushqimin e dhuruar në asnjë rast. Do të bashkëpunojnë dhe do të jenë të hapur me bankat dhe programet e tjera mbi ushqimin.
6. Do të përpiqen të ngrejë ndërgjegjësim në publik ndaj çështjes së urisë, shpërdorimit të ushqimit dhe të faktorëve që kontribuojnë për këtë gjë.
7. Do të përpiqen të prezantojnë aktivitete me qëllim që të reduktojnë nevojën për ndihmë ushqimore.
8. Do të sigurojnë një varietet të gjerë të cilësisë së ushqimit cilësor, të përshtatshëm për konsum dhe të dorëzuar para datës së rekomanduar të përdorimit.
9. Do të bëjnë lidhjen e donatorëve të organizatave jofitimprurëse, bamirëse dhe organizatave që shërbejnë ose ndërveprojnë me familjet në varfëri ose në nevojë urgjente e të përkohshme të ushqimit.
10. Do të jenë transparente në veprimet e tyre duke ruajtur të dhënat e çdo hyrjeje ushqimore dhe të çdo dorëzimi.
11. Do të edukojnë brezin tjetër në të gjitha aspektet e varfërisë, shpërdorimit ushqimor, ngrënies së shëndetshme, mjedisit dhe menaxhimit të ushqimit.
12. Do të jenë novatorë dhe do të zbatojnë projekte unike për të reduktuar shpërdorimin e ushqimit në industrinë e përpunimit ushqimor, të prodhuesit, shpërndarësit, fermat, tregjet dhe në çdo hallkë të zinxhirit të ushqimit.

### MISIONI

**Misioni ynë si organizatë kundër varfërisë është krijimi i inisiativave të zgjuara, programeve dhe projekteve, me qëllim që të jemi në gjendje të ushqejmë të gjithë të uriturit dhe të kemi siguri ushqimore për këdo në Shqipëri.**

Ne besojmë që mund të punojmë së bashku për të eliminuar urinë në Shqipëri duke luftuar varfërinë dhe duke u kujdesur për një mjedis më të pastër në të njëjtën kohë. Ne gjithashtu nxisim punësimin dhe pavarësinë ekonomike me qëllim që njerëzit të jetojnë me dinjitet e të kenë një të ardhme më të mirë.

## VLERAT

- ✦ **Solidariteti** - Të themelojmë një rrjet efikas të institucioneve shtetërore, organizatave, bizneseve dhe individëve që punojnë së bashku, jo në mënyrë konkurruese, por për një qëllim të përbashkët.
  
- ✦ **Dinjiteti** - Ne respektojmë këdo që mbështesim. Nuk i gjykojmë njerëzit prej rrethanave financiare. Të gjithë meritojnë dashuri dhe askush nuk duhet të jetë i uritur.
  
- ✦ **Integriteti** - Ndershmëria është një komponent thelbësor i marrëdhënieve tona.
  
- ✦ **Profesionalizmi** - Përgjegjësia jonë si administratorë të kohës, parasë dhe burimeve të partnerëve tanë është e rëndësishme. Të gjitha punët tona zbatohen në një mënyrë profesionale.